

# DOKUMENT QËNDRIMESH

**MBI RASTET E SHPËRDORIMIT TË BURIMEVE  
PUBLIKE NË PROCESIN PARAZGJEDHOR TË  
MUAJVE JANAR-MARS 2025**

**DOKUMENT QËNDRIMESH**  
**MBI RASTET E SHPËRDORIMIT TË BURIMEVE PUBLIKE NË PROCESIN**  
**PARAZGJEDHOR TË MUAJVE JANAR-MARS 2025**

*Publikuar në 25 Mars 2025*

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Qëndresa Qytetare

Përgatiti:

Znj, Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Rigels Xhemollari, Drejtor Ekzekutiv, Qëndresa Qytetare

Z. Emanuel Xhindi, Asistent Ligjor dhe Asistent Projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Kristian Prela, Avokat, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Instituti i Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

PO BOX no.1752; Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732;

E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al);

Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)

**Përmbajtje**

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. Metodologji.....</b>  | <b>3</b>  |
| <b>2. Përmbledhje ekzekutive.....</b>   | <b>5</b>  |
| <b>3. Denoncimet, proceset administrative dhe praktikat e para vendimarrëse të KQZ... 7</b>   | <b>7</b>  |
| <b>3.4 Programi Social i Strehimit për Subvencionimin e Interesave të Kredisë.....</b>  | <b>11</b> |
| <b>3.5 Shfrytëzimi i godinave në administrim shtetëror për zyrë elektorale dhe organizim të aktiviteteve me natyrë politike .....</b> | <b>12</b> |
| <b>3.6 Zhvillimi i aktiviteteve me natyrë politike në godina në administrim shtetëror ..</b>  | <b>13</b> |
| <b>3.7 Hapja e thirrjes për aplikime nga Bashkia Tiranë për mështetje financiare (Grant) për biznese të reja të gjelbërta .....</b>   | <b>14</b> |
| <b>3.8 Hapja e thirrjes për projekte nga Bashkia Durrës për promovimin e artit, kulturës dhe trashëgimisë .....</b>                   | <b>15</b> |
| <b>4. Rekomandimet .....</b>  | <b>17</b> |

## 1. Metodologjia

Prej datës 11 Janar 2025 nisën detyrimet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, sipas të cilave institucionet dhe zyrtarët publikë duhet të respektojnë ndalesat e parashikuara në nenin 91 dhe 92 të këtij kodi, për të parandaluar keqpërdorimin e burimeve shtetërore në procesin zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme parlamentare të dt.11 Maj 2025.

Komisioni Rregullator në 21 dhjetor 2024 rishikoi Vendimin nr. 9 të dt. 24 dhjetor 2020, duke detajuar më tepër veprimtaritë e ndaluara për tu promovuar, ndalesat për zyrtarët publike, rregullat për raportimin e aktiviteteve publike dhe vendimmarrjet e mundshme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në raste të denoncimeve apo mos raportimeve nga ana e institucioneve publike.<sup>1</sup>

Përgatitja e këtij dokumenti mbështetet në një proces monitorimi konkret, nëpërmjet të cilit vëzhguesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe Qëndresës Qytetare (QQ) kanë konstatuar raste të cilat krijojnë baza të arsyeshme për të pretenduar se janë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit zgjedhor, për sa i takon administrimit të drejtë të burimeve shtetërore në fushatë zgjedhore, si dhe në një periudhë më të zgjeruar 4 mujore nga dita e votimit, në përputhje me nenin 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor. Në funksion të pavarësisë së secilës prej organizatave tona, rastet e trajtuara në vijimësi analizohen nga ekspertët përkatës të të KShH-së dhe QQ-së.

*Baza ligjore e veprimtarisë së organizatave të mësipërme dhe vëzhguesve të tyre është neni 91 i Kodit Zgjedhor, i cili sanksionon në mënyrë të shteruar rastet se kur përdorime të caktuara të administratës shtetërore, do të përbëjnë shkelje dhe rrjedhimisht, praktika të gabuara të qeverisë në krijimin e një klime favorizuese për një proces zgjedhor të rregullt dhe me integritet:*

*1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*

*3 Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.*

<sup>1</sup> [https://kqz.gov.al/document/vendimkrr\\_2024\\_16\\_p%D1%91r-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-9-date-24-12-2020-te-komisionit-rregullator-per-rregullat-e-raportimit-te-veprimtarive-me-karakter-publik-te-cdo-institu/](https://kqz.gov.al/document/vendimkrr_2024_16_p%D1%91r-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-9-date-24-12-2020-te-komisionit-rregullator-per-rregullat-e-raportimit-te-veprimtarive-me-karakter-publik-te-cdo-institu/)

3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike.

Nga interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Zgjedhor me ato të Vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, që të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative që lidhen me (keq)përdorimin e burimeve shtetërore, duhet që të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative. Së pari, duhet që veprimtaria të jetë kryer nga një prej subjekteve të ngarkuar me detyrime nga ligji dhe aktet nënligjore. Së dyti, duhet që veprimtaria të përfshijë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike. Dhe së treti, duhet që vënia në dispozicion e aseteve publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore

*Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet*, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

*Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike*, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi ose administrim të organeve publike qendrore ose të njësive të vetëqeverisjes vendore.

*Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike*, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.

Në vijim të analizës së mësipërme, denoncimet dhe kërkesat drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për fillimin e hetimit administrativ, kanë pasur në përmbajtje të tyre një sqarim të përmbledhur dhe të detajuar të situarës konkrete, shoqëruar me nërlidhjen e kësaj të fundit me bazën ligjore të shkelur nga subjekti konkret.

Vëzhguesit e të dyja organizatave janë individë të paanshëm, të cilët janë angazhuar në monitorimin në terren të shpërdorimit të administratës publike, pa patur konflikte konkrete interesash, një kusht ky i cili i ka lejuar organizatat autore të këtij dokumenti, për të kryer veprimtarinë e tyre denoncuese në mënyrë të pavarur.

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Në periudhën pararendëse të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025, vëzhguesit e KShH dhe QQ kanë konstatuar disa raste të diskutueshme të shkeljeve të legjislacionit zgjedhor dhe akteve relevante nënligjore të shpërdorimit të aseteve publike për qëllime zgjedhore. Themi të diskutueshme, pasi analiza e rasteve të veçanta në këtë raport nxjerr në pah gjithashtu një vakum ligjor që përdoret nga institucionet shtetërore për të krijuar një disavantazh në konkurrim gjatë periudhës 4 mujore dhe fushatës së ligjshme zgjedhore, një muaj para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

Ky vakum ligjor vjen si rrjedhojë e dispozitave jo të harmonizuara në Kodin Zgjedhor, Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për vetëqeverisjen vendore, si dhe nevojës për të përmirësuar vetë aktin rregullator të KQZ-së, vendimit nr.9, dt.24.12.2020, të ndryshuar, sikurse do të analizohet në vijimësi të këtij dokumenti.

Në përgjithësi, ekziston ende një shpërdorim i rrjeteve sociale të institucioneve publike për të shpërndarë aktivitetet dhe programet politike të kandidatëve për deputetë. Sipas një vendimi *precedent*<sup>2</sup> nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, rrjetet sociale të institucioneve të administratës shtetërore do të konsiderohen si “burime publike”, mbi të cilat do të rëndojnë të gjitha rregullimet ligjore që lidhen dhe me asete të luajtshme ose të paluajtshme në administrim shtetëror, referuar nga neni 91 pika 1 e Kodit Zgjedhor.

Pavarësisht një angazhimi të përgjithshëm të nëpunësve të administratës publike për të shpërndarë dhe pëlqyer postimet e këtyre kandidatëve, si dhe përdorimit të faqeve në rrjetet sociale të këtyre institucioneve për shpërndarjen e aktiviteteve elektorale të kandidatëve për deputetë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka ndjekur një metodë interpretimi jo rigoroze, për sa i takon dispozitave përkatëse të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, duke treguar një “tolerancë”, ndonjëherë edhe të paarsyetuar mjaftueshëm, për *gabimet njerëzore* të personave që menaxhojnë këto profile në rrjetet sociale. Në të vërtetë, denoncimet e QQ kanë sjellë në pah një fenomen tjetër shqetësues: shpeshherë, menaxherët e rrjeteve sociale të institucioneve publike, administrojnë edhe profilet publike të kandidatëve në fjalë.

Konstatojmë se praktika të tilla janë në kundërshtim të plotë me frymën e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe dispozitat relevante të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, duke krijuar një disavantazh të theksuar në garën elektorale.

<sup>2</sup> Vendim nr. 421, datë 03.05.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 222 ID, të organizatës “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” dhe denoncimit nr. 228 të deputetit zj. Albana Vokshi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

Në fillim të këtij viti, Këshilli i Ministrave mori një vendim për dhënien e një mbështetjeje financiare kategorisë së pensionistëve, duke ulur fondin përkatës për politikën e pensioneve, dhe duke rritur konsiderueshëm fondin e parashikuar për bonusin financiar të pensionistëve. Megjithëse formalisht vendimi është marrë tej afateve katër mujore nga dita e votimit, parashikuar nga neni 91 i Kodit Zgjedhor, efektet e tij do të shtrihen në Mars të vitit 2025, pra brenda periudhës së ndaluar për *mbështetjet ekonomike/sociale* për kategori të caktuara të popullsisë.

Në këto kushte, interpretimi i nenit 91 të Kodit Zgjedhor nuk duhet të kufizohet në kufijtë e ngurtë kohorë të marrjes së vendimeve, por më tepër se kaq, duhet të konsiderojë edhe kohën e pasojave konkrete që do të prodhojnë vendime të tilla. Lëvizjet financiare të parashikuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave përbëjnë një masë e cila, ndonëse i shamngjet kontrolleve formale financiare elektorale, në thelb sjell një përdorim të burimeve shtetërore për të siguruar një avantazh elektoral të drejtpërdrejtë për partinë në pushtet. Këto raste nxjerrin në pah domosdoshmërinë e parashikimeve ligjore më të forta për ndalimet e shpërdorimeve të burimeve publike për qëllime elektorale.

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar raste të vazhdueshme të hapjes së thirrjeve për projekte apo mbështetje financiare nga bashki të caktuara, për mbështetjen e *modeleve të gjelbra* të biznesit dhe veprimtarive të tjera kulturore. Në thelb, këto thirrje duhet të interpretohen si nënkuptim i togfjalëshit “mbështetje ekonomike/sociale” të parashikuara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor. Edhe pse të gjitha thirrjet e referuara në këtë dokument janë hapur përpara afatit të ndaluar katër mujor nga dita e votimit, shqyrtimi i aplikimeve dhe vendimmarrja për shpalljen e fituesve do të bëhen brenda kësaj periudhe, proces i cili është në kundërshtim me kërkesat ligjore zgjedhore.

QQ ka konstatuar se Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka ndërmarrë një tur takimesh me të zgjedhur vendor, grupe interesi, profesionistë të fushave të ndryshëm dhe qytetarë të thjeshtë, veprimtari kjo e cila, sipas Kuvendit, ka pasur në qëllim të vetë informimin e qytetarëve mbi nismat ligjore në favor të tyre. Në të vërtetë, takimet e realizuara nga Kryetarja kanë pasur natyrë elektorale, dhe kjo gjë është lehtësisht e konstatueshme nga natyra e fjalimeve të mbajtura.

Edhe pse të gjitha veprimtaritë e përcjella pranë KQZ-së janë publike, KShH dhe QQ nuk kanë konstatuar asnjë rast të fillimeve të hetimeve *ex-officio* të Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kjo përbën një shqetësim të vazhdueshëm, i cili është konstatuar nga veprimaria monitoruese e KShH edhe në zgjedhjet e kaluara<sup>3</sup>. Rastet e trajtuara në këtë raport evidentojnë nevojën për një hetim më të shpejtë administrativ në kohë të tyre nga KQZ-së. Disa prej këtyre rasteve po bëjnë afro një muaj që janë depozituar pranë KQZ-së por ende nuk ka një vendimmarrje lidhur me to. Të ndërgjegjshëm për ngarkesën e shtuar institucionale të KQZ-së, vlen të evidentohet se një hetim në afatet maksimale ose tejkallim të tyre, e dobëson rolin e KQZ-së si organi i

<sup>3</sup> Raport Studimor mbi Hetimet dhe Sanksionet Administrative të KQZ-së: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2024/06/Hetimet-dhe-Sanksionet-Adm-te-KOZ.pdf>



vetëm për hetimin dhe ndëshkimin administrativ të këtyre shkeljeve, e po kështu, nuk ndihmon edhe në hetimin penal të tyre, nëse ka elementë të veprës penale.

### **3. Denoncimet, proceset administrative dhe praktikat e para vendimarrëse të KQZ**

#### **3.1 Bonusi i pensioneve, tejkalim i ligjit për të siguruar avantazh elektoral**

Këshilli i Ministrave, pra qeveria vendosi të ndajë një mbështetje financiare prej 10,000 lekësh për pensionistët, një masë e cila do të ketë efekte financiare në mars 2025, vetëm dy muaj para zgjedhjeve parlamentare. Ky vendim, i miratuar në fillim të janarit 2025, shtrihet brenda limiteve të përdorimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në limitet e periudhës së pamundësisë vendimarrëse për shkak të nisjes së periudhës zgjedhore. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën gjashtë miliardë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë lekë.

Nga këndvështrimi ligjor, ky akt krijon një situatë të debatueshme, pasi ndonëse vendimi është marrë brenda afateve të një viti buxhetor, efektet e tij financiare shtrihen në një periudhë kur ndërhyrjet e qeverisë mund të ndikojnë në prirjet elektorale të votuesve. Ligji aktual nuk parashikon ndalime të qarta për ndryshime të tilla në prag zgjedhjesh, duke lënë hapësirë për interpretim dhe për shfrytëzim të boshllëqeve ligjore.

Përmes një akti normativ, qeveria ka rishikuar buxhetin duke ulur me 59% fondin e planifikuar për politikën e pensioneve, një masë që do të kishte siguruar rritje të qëndrueshme të pensioneve mujore. Në të njëjtën kohë, është rritur me 170% fondi i parashikuar për bonusin e pensionistëve, një shpërblim që jepet vetëm për një periudhë të caktuar dhe nuk ka ndikim afatgjatë në mirëqenien e tyre financiare.

Ndryshimet në strukturën e buxhetit, ndonëse teknikisht të justifikueshme brenda vitit fiskal 2024, paraqesin një strategji financiare që shfrytëzon vakumin ligjor për të siguruar një avantazh elektoral. Në vend që të përqendrohet në rritje të përhershme të pensioneve, qeveria ka zgjedhur të zhvendosë burimet drejt një shpërblimi të menjëhershëm, i cili, në kontekst elektoral, mund të perceptohet si një mjet për të ndikuar në preferencat e votuesve.

Ky manovrim përfaqëson një formë të "xhonglimit financiar", ku përmes ristrukturimit të fondeve brenda kufizimeve të ligjit, qeveria arrin të shmangë ndalimet formale të ndërhyrjeve buxhetore në prag të zgjedhjeve. Në thelb, ky është një përdorim strategjik i burimeve shtetërore për të krijuar një perceptim pozitiv tek një kategori e gjerë e votuesve, pa e tejkaluar kufirin teknik të një ndërhyrjeje direkte zgjedhore.

Ky rast tregon domosdoshmërinë e rishikimit të kuadrit ligjor për përdorimin e burimeve publike në periudha zgjedhore, në mënyrë që të shmangët ndikimi i drejtpërdrejtë i politikave financiare mbi elektoratin. Në mungesë të një rregullimi të tillë, qeveritë në pushtet mund të vazhdojnë të shfrytëzojnë hapësirat ligjore për të orientuar politikën fiskale me qëllim favorizimin e tyre në zgjedhje.

Pika 4, e nenit 91, të Kodit Zgjedhor parashikon se, katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohejt propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve

ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore. **Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton se ndalimi për miratimin e akteve ligjore apo nënligjore që krijojnë përfitime për kategori të caktuara.**

### **3.2 Nisma “Kuvendojmë për Shqipërinë”, përdorim i fondeve publike për aktivitete politike**

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Elisa Spiropali, nisi në muajin Tetor iniciativën “Kuvendojmë për Shqipërinë”, që sipas informacioneve të Kuvendit, ka për synim informimin e qytetarëve për nismat në interes të tyre, për të mbledhur opinione dhe zgjidhje mbi projektligje të caktuara.

Sipas shkresës dërguar Qëndresës Qytetare, Kuvendi ka informuar se gjatë turit “Kuvendojmë për Shqipërinë”, Kryetarja e Kuvendit ka pjesë të agjendës takime me të zgjedhurit vendor, qytetarë, grupe interesi, gjithashtu dhe sesione informimi për të rinjtë. Po ashtu, Kuvendi informon se, kjo iniciativë vjen në kuadër të përmbushjes së angazhimeve që rrjedhin nga Plani Strategjik i Kuvendit të Shqipërisë 2020 – 2025.

Në të trija vizitat e monitoruara nga QQ, Kryetarja e Kuvendit, së bashku me Kryetarët e Bashkive Dimal, Peqin, dhe Himarë, kanë vizituar institucione të arsimit parauniversitar, më konkretisht, shkollën 9 – vjeçare “Meleq Gjozi” në Gorican, Dimal, gjimnazin “Zihni Magani” në Peqin, dhe gjimnazin “Spiro Gjikhuri” në Himarë. Sipas denoncimeve publike, në mënyrë të detyrueshme është ndërprerë procesi mësimor, me qëllim pjesëmarrjen dhe dëgjuesën e Kryetares së Kuvendit, e cila në fjalimin e saj, raportohet se ka përdorur propagandë politike.

Ndonëse të gjitha këto aktivitete janë cilësuar si pjesë normale dhe rutinore e punës së Kryetares së Kuvendit, në fakt këto aktivitete janë qartësisht të një natyre elektorale. Ky fakt provohet qartazi nga takimi i zhvilluar në ambientet e Teatrit “Skampa”.

Më datë 11.03.2025, është zhvilluar turi i tretë i takimeve, duke filluar nga Himara dhe vijuar më pas në Vlorë. Gjatë këtij turi, krahas takimeve me kryetarët e bashkive, janë zhvilluar vizita në gjimnazin “Spiro Gjikhuri”; takime me studentë të Universitetit “Ismail Qemali” një darkë me gra biznesmene, si dhe takimi “Kuvend-On”. Në këto takime, vërehet edhe prezenca e Z. Bledi Çuçi, prezencë të cilën, Kryetarja e Kuvendit e ka lidhur me qenien e tij zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë. Krahas këtij funksioni, Z. Çuçi mban edhe funksionin e Drejtuesit Politik të Partisë Socialiste në Vlorë. Pikërisht ky fakt, si dhe video e transmetimit të takimit “Kuvend-On”, provojnë natyrën tërësisht politike të këtyre aktiviteteve. Sikundër rezulton, gjatë takimit, Znj. Spiropali dhe Z. Çuçi kanë bërë propagandë politike duke përdorur, ndër të tjera, shprehje si “votuesit tanë”, “Për inat të Edi Ramës dhe qeverisë, nuk mund t’i biesh Shqipërisë”; “reformën në drejtësi e kemi bërë me kosto të madhe politike”; “ne e kemi një lloj pengu si qeveri këto vite që qeverisim Shqipërinë”, etj.

*Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje. Në rastin konkret, burimet publike të vendosura në dispozicion të Partisë Socialiste janë fondet e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe institucionet arsimore, ku janë zhvilluar takimet e sipërcituara. Për rrjedhojë, ky kusht i parë në lidhje me subjektin ndaj të cilit duhet të jenë vënë në mbështetje dhe prej të cilit janë përdorur burimet, plotësohet në rastin konkret.*

*Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi të organeve publike qendrore ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Siç rezulton edhe nga rrethanat e çështjes, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti të dytë.*

*Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore. Në rastin konkret, është e qartë që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore është bërë për qëllime zgjedhore. Po ashtu, për aq kohë sa nga përdorimi i burimeve publike është kryer në favor të një partie politike, edhe kjo e fundit duhet të mbahet përgjegjëse për shkelje të ndalimeve të Kodit Zgjedhor.*

### **3.3 Keqpërodrimi i rrjeteve sociale nga nëpunësit dhe institucionet publike**

Nga data 11 janar 2025 dhe në vijim, monitoruesit e Qendrës “Qëndresa Qytetare” kanë vërejtur se, faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitare, Zyrave Vendore të Arsimit, si dhe faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të gjitha këto institucione në varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, janë angazhuar në forma të ndryshme, duke përfshirë pëlqimin, komentimin apo shpërndarjen, me postime që kanë në përmbajtje të tyre thirrje elektorale. Në vijim, për të treguar shkallën e përhapjes së këtij fenomeni, do të përmendim disa nga rastet për secilin prej postimeve: Më datë 11 janar 2025, ora 15:22, nga profili i Znj. Ogerta Manastirliu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “🇹🇷 *Athinë* 🇸🇰 - *Kënaqësi e veçantë të takoja Linditën, Etleven, Dudinën, Robertin, Durimin, Gastonin, tiranas të mirë e të mençur, që prej vitesh jetojnë në Athinë, por që kurrë s'i kanë shkëputur lidhjet me atdheun* 🇷🇸. *Faleminderit Janit për organizimin dhe mbështetjen* 🙏 *Bashkë ndamë informacionin mbi mundësinë historike të votës nga diaspora në zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025 dhe procesin e regjistrimit në platformën e KQZ. Nga sot, 11 Janar nis regjistrimi për zgjedhësit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit* ✅ *deri në 4 Mars! Regjistrohuni në Platformën Elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <https://diaspora.kqz.gov.al>* 🇸🇰 ***Mos e humb mundësinë të vendosësh për të ardhmen e fëmijëve dhe për Shqipërinë e 2030*** 🇷🇸🇸🇰 ***#DiasporaVoton*** 🇷🇸🇸🇰 ***#PS2030*** 🇷🇸🇸🇰 ***për #Shqipërinë2030*** 🇷🇸🇸🇰”.

Në këtë postim janë angazhuar në formën e pëlqimit, ndër të tjera, Shkolla 9 – vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës,

Shkolla e Mesme e Bashkuar “Arif Zeqiri”, Golaj, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë, dhe në formën e shpërndarjes, ndër të tjera, nga faqja zyrtare Shkollës Publike 9 – vjeçare “Koli Sako”, Divjakë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier; Shkolla 9 – vjeçare “Jashar Dunga”, Kajan, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë.

Njëkohësisht monitoruesit e Qendrës “Qëndresa Qytetare” kanë vërejtur se, faqet zyrtare të institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë drejtoritë e shërbimit spitalor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, spitalet bashkiake dhe qendrat shëndetësore, janë angazhuar me shpërndarjen e postimeve që janë tërësisht me përmbajtje politike. Në vijim, për të treguar shkallën e përhapjes së këtij fenomeni, do të përmendim vetëm disa nga rastet e konstatuara nga ana jonë, megjithatë, këto raste nuk janë të vetmet dhe për këtë shkak, i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që kryesisht, të hetojë në mënyrë të thelluar rastet e shpërdorimit të burimeve publike nga ana e institucioneve politike.

Më datë 2 shkurt 2025, nga profili i Znj. Albana Koçiu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “*Sot në Kuvendin Rinor të Partisë Socialiste 🌹, mes energjisë dhe entuziazmit të të rinjve ❤️.*”. Ky postim është shoqëruar me fotografi të ndryshme të realizuara gjatë Kuvendit Rinor të Partisë Socialiste të zhvilluar në ambientet e Pallatit të Koncerteve. Më datë 1 shkurt 2025, nga profili i Z. Edi Rama, është transmetuar në kohë reale Kuvendi Kombëtar Rinor i Partisë Socialiste. Ky transmetim është shoqëruar në përmbajtjen e tij me përshkrimin “Kuvendi Kombëtar Rinor për Shqipërinë 2030 🇲🇪🇸🇰🇷🇵🇸🇷🇺 [#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇲🇪 [#VetëmPërpara](#) 🇸🇰🇷🇵🇸🇷🇺 [#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇪🇸🇰🇷🇵🇸🇷🇺.”

### **Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi pushimin e te dyja çështjeve, sepse arsyetoi që Kodi Zgjedhdor ka qëllim ndërgjegjësores, jo ndëshkues, dhe për aq kohë sa postimet ishin fshirë, nuk konstaton shkelje. Por këto raste shërbyen si indicie që KSHZ të dalë me një vendim të unifikuar, për të specifikuar dhe rregulluar angazhimin e zyrtarëve dhe institucioneve publike në rrjetet sociale. Vendimi nr. 240, dt. 04/03/2025 sanksionon rregullat e mëposhtme si pasojë e fenomeneve të denoncuara nga Qëndresa Qytetare dhe aktorët e tjere:

1. Llogari zyrtare në rrjetet sociale është llogaria që është hapur dhe përdoret nga funksionari publik për shkak të detyrës që kryen, e cila përmban emrin e institucionit dhe funksionin publik, si dhe llogaria që është hapur dhe përdoret nga institucioni publik përkatës, përdorimi dhe përditësimi i së cilës bëhet nga strukturat përkatëse për median dhe informimin në këtë institucion. Nuk përfshihen në këtë përkufizim llogaritë personale dhe adresat në rrjetet sociale, të cilat përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin e funksionarit publik dhe nuk lidhen me funksionin publik të tij.
2. Funksionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt ose indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjetet sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.

3. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik.
4. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, si dhe postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik.

### 3.4 Programi Social i Strehimit për Subvencionimin e Interesave të Kredisë

Nëpërmjet një njoftimi me datë 10.01.2025<sup>4</sup>, në rrjetet sociale dhe faqen e saj zyrtare të internetit, Bashkia Lezhë ka hapur thirrjen për aplikime në Programin Social të Strehimit për Subvencionimin e Interesave të Kredisë, me afat afro një muaj, deri më datën 11.02.2025. Më datë 11.02.2025, ky afat është shtyrë deri në datën 11.03.2025.<sup>5</sup>

Nisur nga përmbajtja e pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, bazuar në sinjalizimin e vëzhguesve të tij, KShH i është drejtuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me një kërkesë për fillimin e hetimit administrativ.

Megjithëse vlen të saktësohet se në këtë rast, burimet publike nuk janë vendosur në dispozicion të ndonjë subjekti politik, KShH ka argumentuar, në shkresën drejtuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, se raste të tilla përbëjnë miratime të akteve nënligjore, me qëllim dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht mbështetjen ekonomike apo sociale.

Ky argument, përforcohet edhe nga fakti se thirrja për aplikime ka vendosur disa kritere të mëtejshme për kategori të caktuara aplikuesish, të cilët do të kenë përparësi në përzgjedhje. Konkretisht:

1. Çiftet e reja dhe të rinj me moshe jo më të madhe se 40 vjeç;
2. Gra kryefamiljare/ gra të dhunuara;
3. Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë;
4. Familjet me më shumë se 4 fëmijë;

Më tej, KShH vlerëson se iniciimi i një nisme të tillë nga ana e Bashkisë Lezhë, duke mos qenë parashikuar në një zë buxhetor të veçantë<sup>6</sup>, zgjatja e afatit të aplikimeve deri më datën 31.05.2025 përbën jo vetëm një shkelje të drejtpërdrejtë të pikës së katërt të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 pika 3 të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e

<sup>4</sup> <https://lezha.gov.al/njoftim-mbi-hapjen-e-thirrjes-per-aplikime-per-programin-social-te-strehimit-subvencionimin-e-interesave-te-kredise/>

<sup>5</sup> <https://lezha.gov.al/njoftim-per-shtyrje-afati-programi-social-i-strehimit-subvencionim-i-interesave-te-kredise/>

<sup>6</sup> [https://lezha.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/PBA-2024-2026\\_compressed.pdf](https://lezha.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/PBA-2024-2026_compressed.pdf)

veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, por krijon premisa të forta të besimit të arsyeshëm se programi në fjalë mund të përdoret si një mjet elektoral për favorizimin e subjekteve të caktuara politike.

Deri në kohën që mbulon ky raport, rezulton që Bashkia Lezhë të ketë depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pretendimet e saj për rastin e mësipërm.

### **3.5 Shfrytëzimi i godinave në administrim shtetëror për zyrë elektorale dhe organizim të aktiviteteve me natyrë politike**

Bazuar në sinjalizimet e vëzhguesve të tij, KShH ka përcjellë pranë KQZ-së, rastin e përdorimit nga Partia Socialiste e Shqipërisë për zyrën e saj elektorale në qytetin e Elbasanit, të një godine e cila ka qenë në administrim shtetëror.

Sipas pretendimeve të KShH-së, ambjenti në fjalë ka qenë deri para pak muajsh nga sinjalizimi i KShH-së (shkurt 2025) në përdorim të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Nga përgjigjja e Bashkisë Elbasan drejtuar KQZ-së, kemi konstatuar se në të vërtetë, bëhet fjalë për ambjentin “Ish Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 852, i cili sipas VKM Nr. 337 Dt. 09/06/2021, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Elbasan.

Nga Bashkia Elbasan është vënë në dispozicion Vendimi Nr. 84 i Këshillit Bashkiak të Elbasanit me datë 31.08.2021, Nr. 3918/1 Prot., ku është miratuar dhënia në përdorim pa kundërshtim të ambjentit “ish Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, Z.K 8521, Partisë Socialiste dega Elbasan nga Bashkia Elbasan.

Në bazë të këtij vendimi, është lidhur më datë 03.09.2021, Kontrata e Huapërdorjes midis Partisë Socialiste të Shqipërisë në cilësinë e huamarrësit, dhe Bashkisë Elbasan në cilësinë e huadhënësit, me Nr. Prot 2849/1.

Bashkia Elbasan argumenton se këto veprime janë kryer në bazë të neneve 22 dhe 22/1 të ligjit Nr 8580 dt. 17.03.2020 “Për Partitë Politike”, ku saktësohet se për pajisjen me ndërtesë për selinë vendore, partitë politike duhet t’i bëjnë një kërkesë Kryetarit të Bashkisë, në mënyrë që të lidhet një kontratë huapërdorje për ndërtesa të lira.

Për sa më sipër, vërehen dy probleme thelbësore:

- 1) Pavarësisht se pika 1 e nenit 91 e Kodit Zgjedhor vendos një rezervë ligjore për sa i takon përjashtimeve të ndalimeve të vënies në përdorim politik të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme shtetërore (përvec rasteve të parashikuara me ligj), vërejmë se ka një kundërshti midis frymës së kësaj të fundit dhe nenit 22/1 të ligjit Nr. 8580 “Për partitë politike”, i cili vendos si procedurë të rregullt lidhjen e kontratave të huapërdorjes midis subjekteve politike dhe bashkive përkatëse, kontrata, të cilat sipas nenit 901 të Kodit Civil, janë kontrata pa kundërshtim. Duke pasur parasysh kontekstin politik shqiptar dhe rastet e mëparshme të shpërdorimit të administratës publike, vërejmë se një shtrat i tillë ligjor krijon baza për vendosjen e burimeve publike në favor të partisë në pushtet,

pavarësisht kësaj të fundit dhe periudhës në të cilën bëhet ky veprim. Nga sa më sipër, konsiderojmë të nevojshëm rishikimin e vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9 datë 24.12.2020, i cili duhet të jetë më i qartë dhe detajues për të ndaluar vënien e aseteve publike në disponim të partisë në pushtet. Po ashtu, tërësia e akteve ligjore dhe nënligjore duhet të jetë koherente duke marrë parasysh edhe faktin se partia e cila kandidon në zgjedhje është njëherazi edhe në Pushtet Ekzekutiv, por gëzon edhe Pushtetin Vendor. Në një rast të tillë ndërhyrja e interesave politikë është edhe më evidente. Krijimi i një klime të tillë mbytëse për garën e drejtë, të barabartë e të ndershme, pavarësisht se formalisht mund të përputhet me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, në thelb çënon plotësisht garën, duke krijuar favore të padrejta.

- 2) Më tej, as ligji “Për Partitë Politike” dhe as VKM-ja përkatëse nuk përcaktojnë një afat maksimal për zgjatjen e kontratës së huapërdorjes që mund të lidhet në këto raste, duke krijuar premisa për shpërdorim të burimeve publike për qëllime politike.

Denoncimi i mësipërm është adresuar në KQZ dhe ndodhet në fazë hetimi administrativ nga kjo e fundit. Deri më tani janë marrë pretendimet e të denoncuarit dhe denoncuesit dhe pritet për vendimarrje.

### **3.6 Zhvillimi i aktiviteteve me natyrë politike në godina në administrim shtetëror**

Ngjashëm me rastin e mësipërm, bazuar në sinjalizimet e vëzhguesve të KShH-së kemi përcjellë në KQZ një tjetër rast të ndodhur në Bashkinë Elbasan, ku është pretenduar se në godinën e ish-Kinema “Vullnetari (me adresë në Elbasan, Qendra Rinore pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani, Godina Kryesore), ndërtesë e cila është në administrim shtetëror, është zhvilluar një takim elektorale më datë 15 janar 2025, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë dhe figurave të tjera të Partisë Socialiste.

Nga Bashkia Elbasan është pretenduar se ambiente të tilla kulturore sportive në administrim shtetëror mund t’u jepen për përdorim subjekteve të ndryshme, mjaft që të mos cenohet veprimtaria rutinore e institucionit përkatës si dhe aktiviteti të mos zhvillohet në orarin zyrtar.

Në këtë rast, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka referuar në shkresën zyrtare të tij drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nën 91 pika 1 dhe 2 e Kodit Zgjedhor, i cili ndalon, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara me ligj, vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara nga neni 142 i Kodit Civil. Më tej, *përdorimi gjatë orarit zyrtar*, sipas nenit 91 pika 2 e Kodit Zgjedhor, lidhet ekskluzivisht me burimet njerëzore të institucionit përkatës, dhe jo me godinën në të cilën është zhvilluar aktiviteti.

Për rrjedhojë KShH ka analizuar në këtë rast të referuar se godina në administrim shtetëror, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara me ligj, nuk mund të vendosen në dispozicion të subjekteve politike për zhvillimin e aktiviteteve elektorale, qoftë edhe jashtë orarit zyrtar.

Ky denoncim i paraqitur para KQZ-së, po hetohet administrativisht nga ana e saj dhe akoma nuk ka një vendimarrje në lidhje me shkeljet e konstatuara.

### **3.7 Hapja e thirrjes për aplikime nga Bashkia Tiranë për mbështetje financiare (Grant) për biznese të reja të gjelbërta**

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se hapja e thirrjes për aplikime nga Bashkia Tiranë për mbështetje financiare bizneseve të mbështetura në mekanizma ekologjikisht të sigurta (*environmentally friendly*) me datë 01.03.2023 dhe afat deri më 31.03.2025, përbën një veprimtari të ndaluar sipas nenit 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor, duke marrë parasysh zhvillimin e thirrjes brenda 4 muajve nga dita e votimit dhe natyrës mbështetëse ekonomike/ sociale, që i takon kësaj thirrjeje për aplikime.

Këto pretendime i janë përcjellë me një shkresë të veçantë KQZ-së, duke i kërkuar që të fillojë hetimin administrativ.

Në kuadër të hetimit administrativ të KQZ-së që ka nisur, rezulton se Bashkia Tiranë ka dërguar parashtrimet e saj duke referuar Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për Ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar, sipas të cilit bashkitë janë një aktor mëse i rëndësishëm për përmbushjen e funksionit të zhvillimit ekonomik vendor, funksion i cili përmbushet nëpërmjet, ndër të tjera, dhënies së granteve/mbështetjes financiare.

Gjithashtu, nga Bashkia Tiranë është referuar edhe Vendimi nr. 167, datë 18.13.2020, i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e projektit “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja “të gjelbërta” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur elementë go-green në to”. Nëpërmjet këtij vendimi është miratuar projekti në fjalë, hartuar sipas Udhëzuesit operacional për zbatimin e tij, i cili synon stimulimin dhe motivimin e sipërmarrësve për të filluar biznese të reja që janë miqësore me mjedisin, të dizenuara për të rritur qëndrueshmërinë mjedisore apo për të zhvilluar biznese që janë të vetëdijshëm për ndikimin e tyre në mjedis drejt një planeti më të gjelbër.

Më tej, Bashkia ka referuar Vendimin nr.131, datë 18.13.2024, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 - 2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2025”, nëpërmjet të cilit është miratuar fondi i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë, në vlerën 18.000.000 lekë, për zbatimin e këtij projekti për vitin 2025.

Bashkia ka argumentuar se afati i aplikimeve është vendosur në periudhat 1 Shkurt - 31 Mars 2025, në mënyrë që ky projekt të jetë i zbatueshëm nga përfituesit e projektit dhe të përfundojë brenda afatit të parashikuar në kontratën që lidhen ndërmjet përfituesit të grantit dhe Bashkisë Tiranë i cili është fundi i muajit nëntor të çdo viti.

Si përfundim, Bashkia Tiranë ka pretenduar se projekti në fjalë është zhvilluar përgjatë viteve 2021-2024 dhe rrjedhimisht hapja për aplikime për mbështetje financiare nuk përbën veprimtari të ndaluar, pasi mbështetja “*nuk është vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, por është ndjekur/zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për dhënien e granteve financiare*”.



Nga parashtrimet e Bashkisë Tiranë, kemi konstatuar se as në Vendimin nr.131, datë 18.13.2024, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 - 2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2025”, nëpërmjet të cilit është miratuar fondi i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë, në vlerën 18.000.000 lekë, për zbatimin e këtij projekti për vitin 2025, as në Udhëzuesin Operacional për Zbatimin e Projektit, as në Vendimin nr. 167, datë 18.13.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e projektit “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja “të gjelbërta” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur elementë go-green në to” nuk ka parashikime të afateve kaq të afërta të aplikimit me datën e votimit. Për rrjedhojë, hapja e thirrjes brenda datave 01.03.2025-31.03.2025 janë lënë në diskrecion të Bashkisë.

Nga ky rast, Komiteti Shqiptar i Helsinkit konkludon se, pavarësisht se mbështetja financiare e referuar është dhënë në vazhdimësi, si dhe afati i afërt me periudhën zgjedhore është vendosur për të zbatuar projektin brenda fundit të nëntorit të çdo viti, grante të tilla financiare, të dhëna në periudha të cilat sanksionohen shprehimisht nga neni 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor si fasha kohore që delegjitojnë këtë proces, duhet të konsiderohen si raste që janë në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor, pasi krijojnë tendenca të dukshme elektorale për përfituesit e tyre, të cilat janë shumë afër me datën e zgjedhjeve. Në këtë rast, konsiderojmë të nevojshëm rishikimin e vendimit e KQZ nr. 9 datë 24.12.2020, i cili duhet të jetë më i qartë dhe detajues për të ndaluar veprimtaritë të cilat synojnë reklamimin dhe tërheqjen e elektoratit në mënyrë të padrejtë drejtë një subjekti të caktuar elektorale. Kryerja e investimeve ose si në rastin konkret, dhënia e granteve afër periudhës zgjedhore, në historinë e zgjedhjeve në Shqipëri, përbën një problem, ngre dyshime për destinimin dhe qëllimin e vërtetë të këtyre granteve. Prandaj partia e cila është në pushtet, ka mundësi më të mëdha të keqpërdorë fondet publike për të krijuar reklamë të mirë për kandidaturën e saj në zgjedhje, e cila sjell favorizim të padrejtë për të dhe i vë kandidatët e tjerë në pozitë më të disfavourshme. Parimi kryesor i zgjedhjeve është se ato duhet të jenë të ndershme dhe të kandidatët të kenë të drejta të barabarta. Në frymën e këtyre parimeve duhet të ecë edhe formulimi i dispozitave në vendimin nr. 9 të datës 24.12.2020.

### **3.8 Hapja e thirrjes për projekte nga Bashkia Durrës për promovimin e artit, kulturës dhe trashëgimisë**

Bazuar sërish në sinjalizimet e vëzhguesve të tij, ngjashëm me rastin e Bashkisë Tiranë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka përcjellë në KQZ, një hapje thirrjeje për projekte nga Bashkia Durrës me datë 03.02.2025, për promovimin e artit, kulturës dhe trashëgimisë. Nga konsultimi me Planin e Buxhetit 2023-2025 publikuar nga Bashkia Durrës, nuk ka një parashikim të veçantë në lidhje me këtë aktivitet. Për më tepër, përzgjedhja e kohës që është bërë për hapjen e thirrjeve për të financuar projekte të tilla, përkon me ndalimin e parashikuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe sipas nenit 3 pika 1.1 gërma “b” të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> <https://durrës.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Relacioni-pba-2023-2025.docx>

Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i KQZ si një akt rregullator duhet të përmbushë kriterin e saktësisë dhe plotësisë së rregullimit të ndalimeve të parashikuara në ta. Paraqitet nevoja për rishikimin e tij, për arsye se, në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor, kapërcen rezervën ligjore. Kjo dispozitë e fundit e cituar parashikon se: *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor; apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”*

Hapja e thirrjes për projekte në datën 03.03.2025, kualifikohet si veprimtari e ndaluar, pasi është bërë brenda periudhës 4 mujore nga dita e zgjedhjeve, duke u konsideruar konkretisht si “mbështetje sociale”.

Ky rast është denoncuar pranë KQZ, së cilës i është kërkuar nisja e hetimit administrative dhe marrja e masave për evidentimin dhe sanksionimin e veprimtarive të ndaluara. KQZ nuk ka dalë akoma me një vendim i cili ezauron rastin.

### **Dhënia me qira e tre trojeve nga Këshilli Bashkiak i Fierit**

Nëpërmjet një njoftimi zyrtar në faqen e internetit<sup>8</sup>, në rendin e ditës për mbledhjen e datës 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak të Fierit janë futur rishtazi për shqyrtim dy projekt vendime për dhënien me qira të disa trojeve në fshatrat e kësaj bashkie<sup>9</sup>.

Sipas nenit 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 pika 3 të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020, parashikohet se: **Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.**

Thënë kjo, një masë e tillë e marrë nga ana e Bashkisë Fier rreth 3 muaj para datës së zgjedhjeve, krijojnë indicie se një veprim i tillë bien ndesh me nenin 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 pika 3 të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020, duke përbërë një veprim të ndaluar në formën e “dhënies së pasurive...”.

Sipas informacioneve të marra nga vëzhguesit në terren dhënia me qira e këtyre trojeve është miratuar nga Këshilli Bashkiak i Fierit, ndër protestat e vazhdueshme të këshilltarëve bashkiakë të forcës politike në opozitë.

<sup>8</sup> (<https://bashkiafier.gov.al/u-realizua-mbledhja-e-kryesise-se-keshillit-bashkiak-fier-6/>)

<sup>9</sup> Konkretisht nw:

- A) Fshatin Sheq Marinas, Njwsia Administrative Tropojw,
- B) Fshatin Peshtan Bregas, Njwsia Administrative Frakull
- C) Fshatin Hasturkas, Njwsia Administrative Libofshw

#### 4. Rekomandimet

Bazuar në gjetjet e deritanishme, **Qëndresa Qytetare dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit** përcjellin këto rekomandime:

1. **I sugjerojmë Kuvendit të Shqipërisë** përmirësimin e kuadrit ligjor për të adresuar boshllëqet që ndihmojnë partinë politike që ka mazhorancën qeverisëse në përdorimin strategjik të burimeve publike për avantazh elektoral dhe forma të tjera artificiale të shpërdorimit të aseteve publike, të cilat formalisht gëzojnë mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi (nenit 91 të Kodit Zgjedhor, Ligjit “Për partitë Politike”, Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, bazuar edhe në analizën e rasteve të shtjelluara më sipër.
2. **I sugjerojmë KQZ-së** të rishikojë vendimin nr.9, dt.24.12.2020, të ndryshuar, me qëllim që ai të jetë në pajtim të plotë me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe të mos krijojë lehtësi që tejkalojnë rezervën Ligjore të Kodit Zgjedhor, të cilat më tej shfrytëzohen në interes të shpërdorimit të aseteve publike dhe një gare avantazhuese.
3. **I sugjerojmë KQZ-së** të vendosë sanksione proporcionale që i përgjigjen shkeljeve të rënda për përdorimin e institucioneve dhe burimeve shtetërore për qëllime elektorale.
4. **I sugjerojmë të gjitha partive politike garuese për zgjedhjet parlamentare** të dt.11 Maj 2025, të rrisin transparencën në raportimin e shpenzimeve publike gjatë periudhës zgjedhore, për të shmangur manipulimin e fondeve shtetërore.
5. **I sugjerojmë KQZ-së** të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe pro-aktive, me qëllim parandalimin e përgjithshëm e të posaçëm, në drejtim të zbatimit të vendimit të saj për ndalimin e propagandës elektorale në rrjetet sociale të institucioneve publike.
6. **Ne sugjerojmë një angazhim konkret të organit të prokurorisë (SPAK dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm)** për të hetuar në mënyrë më të detajuar dhe të paanshme dhe për të përcjellë në mënyrë periodike statistika cilësore mbi angazhimin për këto raste, të cilat i shërbejnë besimit të qytetarëve në organet e drejtësisë. Në këtë drejtim, nisur nga numri i ulët i denoncimeve që vijnë nga qytetarët dhe raportuar shkeljet e procesit zgjedhor, mendojmë që një kontribut të rëndësishëm ka media e pavarur dhe e paanshme, për të raportuar publikisht raste të shkeljeve që kërkojnë nisjen e një hetimi me inisiativë, konform Kodit të Procedurës Penale.
7. **I sugjerojmë KQZ-së** të marrë një rol të shtuar proaktiv në hetimin administrativ, në afate sa më të shpejta të përdorimit të burimeve shtetërore dhe atje ku është e nevojshme përcjellja e rasteve pranë prokurorive kompetente (SPAK nëse të dyshuar janë zyrtarët e nivelit të lartë ose prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, nëse janë zyrtarë jashtë këtij rrethi). Gjithashtu sugjerojmë fillimin e hetimeve **ex officio** për rastet e shpërdorimit të administratës publike, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në sajë të ndërfaqes së raportimit dhe monitoruesve të KQZ-së në terren.

Këto sugjerime në vlerësimin tonë janë të rëndësishme për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë, të ndershëm dhe të paanshëm në Shqipëri.